



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
QENDRA PER SHERBIMET QY
CENTAR ZA USLUGU GRAFANA

Sh. 02 Nr. 5614
U. Br.
Nr. i faq. 2 Data: 10/03
Br. Str. Datum: Opstina Kamenica
KAMENICE/A 2025 Kamenica Municipality



Datë: 10.03.2025

Në mbështetje të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), në përputhje me nenin 3 paragrafi 3.3, 3.5 dhe 3.10 dhe neni 70 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, dhe Rregulloren Sh.01.Nr.13678 e datës 14.04.2023 të Komunës së Kamenicës për Procedurën e Ndarjes së Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve të tjera, Komuna e Kamenicës shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

PËR PROPOZIME TË KANDIDATËVE PËR NDARJEN E TITUJVE TË NDERIT, ÇMIMEVE DHE MIRËNJOHJEVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS

Komuna e Kamenicës fton qytetarët, institucionet dhe organizatat që të propozojnë kandidatë të denjë për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera, si vlerësim për kontributin e tyre të shquar në fusha të ndryshme, përmes kësaj thirrjeje, ju mund të ndihmoni në përzgjedhjen e personave meritore për titujt e mëposhtëm:

- **Çmimi "Metush Krasniqi":** u jepet personaliteteve të shquara për kontributin e tyre në çështjen kombëtare, për akte trimërie, sakrifice dhe guximi qytetar në kohë lufte dhe paqeje.
- **Titulli "Qytetar Nderi":** është vlerësimi më i lartë që jep Komuna e Kamenicës për personalitete të shquara politike, shoqërore, letrare, artistike dhe të huaj, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për kontributin e tyre në të mirë të qytetarëve të komunës.
- **Çmimi "Emblema e Kamenicës":** u jepet personaliteteve të shquara të Komunës së Kamenicës për kontribut të veçantë në çështjen kombëtare, fusha të rëndësishme dhe interesin e qytetarëve, si dhe për akte të larta guximi dhe sakrifice. Ky çmim mund të jepet edhe pas vdekjes (post mortum).
- **Çmimi "Pena e Artë":** u jepet artistëve dhe personaliteteve të shquara në arsim, art, shkencë dhe kulturë për sukseset e tyre të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky çmim mund të ndahet edhe pas vdekjes për ata që kanë lënë gjurmë të rëndësishme në këto fusha.
- **Titulli "Sportisti i Vitit":** u jepet sportistëve individualë për arritje të jashtëzakonshme në gara kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe për kontributin e tyre në zhvillimin e sportit te brezat e rinj.
- **Çmimi Tradicional Letrar "Ibrahim Ibishi"** u jepet shkrimtarëve të dalluar për kontributin e tyre në letërsi gjatë manifestimit letrar "Lulëkuqet e Prillit". Ai ndahet vetëm brenda këtij aktiviteti, nëse organizatori vlerëson se fituesi ka dhënë kontribut të veçantë artistik dhe ka ndikuar në ngritjen e cilësisë letrare.

- **Mirënjohje dhe Falënderime:** Kryetari i Komunës dhe Drejtorët Komunalë mund të ndajnë "Mirënjohje" dhe "Falënderime" për personalitete që kanë dhënë kontribut të veçantë në fusha të ndryshme në të mirë të komunitetit.

Propozimet duhet të përmbajnë:

- Biografinë e kandidatit të propozuar.
- Arsyetimin - Të sqarohet cili ka qenë kontributi i kandidatit që ai/ajo ta meriton titullin e propozuar.
- Fakte të cilat vërtetojnë arsyetimin.

Procedura për ndarjen e titujve:

- Propozimet shqyrtohen nga një Komision vlerësues, i cili është i formuar nga Kuvendi i Komunës, dhe Komisioni merr një vendim për miratimin ose refuzimin e propozimeve.
- Kuvendi i Komunës organizon seanca solemne për dorëzimin e titujve dhe çmimeve.

Si të Aplikoni:

- Propozimet duhet të dorëzohen deri më 31 mars. Pas këtij afati, propozimet nuk do të shqyrtohen.
- Propozimet duhet të dorëzohen në sportelin e administratës në një zarf të mbyllur, me shënimin "Propozim për Titujt Nderi" dhe t'i drejtohen Zyrës së Kryetarit të Komunës së Kamenicës.
- Propozimet mund të dorëzohen edhe në mënyrë elektronike, përmes emailit zyrtar info.kamenica@rks-gov.net.
- Një subjekt ka të drejtë vetëm një propozim.

Për informacion të mëtejshëm: Ju lutemi kontaktoni znj. Valdete Berisha, Zyrtare në Zyrën e Informimit në Komunën e Kamenicës, në adresën elektronike: valdete.r.berisha@rks-gov.net.


Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj